U kap me arsenal armësh, publikohet foto e 36-vjeçarit me kallashnikov mbi bagazhin e Audit dhe momenti i arrestimit

Shpërndaje

21:30 09/01/2023

Kjo është foto e 36-vjeçarit Antonio Leka, i cili u arrestua pasditen e sotme në Lezhë me arsenal armësh.

Në foton e siguruar nga Klan News duket 36-vjeçari me plis në kokë dhe arma kallashnikov mbi bagazhin e automjetit të tij tip Audi me targa AB 100 AH.

Kjo foto është bërë para arrestimit nga policia të Antonio Lekës. Aty ai ndodhet në një servis, së bashku me vëllain e tij. Në një moment ai ka nxjerrë mbi bagazhin e Audit armën e zjarrit duke e ekspozuar. Vëllai i tij nuk ka mundur ta bindë që të dorëzojë armën. Pasi Antonio Leka u largua prej andej, vëllai i tij sinjalizoi menjëherë policinë se 36-vjeçari ishte i armatosur dhe mund të kryente ngjarje kriminale.

Në këtë video më poshtë, janë pamjet të filmuara nga një kamera amatore, të cilat tregojnë momentin kur Antionio Leka arrestohet në flagrancë nga policia. Në sfond duket automjeti i tij Audi ngjyrë e bardhë, i njëjti mjet që ishte në servis.

Brenda makinës së tij policisë sekuestroi arsenal armësh; një pistoletë me 5 karikatorë, 1 automatik me 5 karikatorë, 550 fishekë luftarakë për pistoletën dhe automatikun, 1 palë dylbi, 1 antiplumb ushtarak, 1 thikë, 1 çantë ushtarake, 75 gramë lëndë e dyshuar narkotike kanabis dhe rroba kamuflazhi. */tvklan.al*

TË NGJASHME

U kap me arsenal armësh, publikohet foto e 36-vjeçarit me kallashnikov mbi bagazhin e Audit dhe momenti i arrestimit

20:30 09/01/2023

Parandalohet ngjarja kriminale, arrestohet 36-vjeçari me rroba ushtarake dhe arsenal armësh

17:48 09/01/2023

Makina bie në humnerë në Rrugën e Arbrit

17:45 09/01/2023

Goditi me mjet prerës të riun, arrestohet 60-vjeçari

15:21 09/01/2023

Dënohen Gentian Goskova dhe Ervis Kosova

15:16 09/01/2023

Në burg nënë e bir që vodhën mbi 520 mijë euro, sanitarja: Ia mora paratë Alda Klosit nga urrejtja

14:39 09/01/2023



Mijëra euro, bizhu, çanta e iPhone! Çfarë vodhën nënë e bir në banesën e Alda Klosit (Lista)

13:21 09/01/2023

25.8 kg kokainë nga Ekuadori në Turqi, vihen në pranga 2 shqiptarë

13:10 09/01/2023



"E urrej Alda Klosin", dëshmia e Rozeta Dobit: Të gjitha paratë janë marrë në banesën e saj

12:20 09/01/2023

© 2022 TV Klan. All Rights Reserved.